

INSTITUCIONI PUBLIK KOMUNAL PËR
FËMIJË

KOPSHTI PËR FËMIJË „SNEZHANA“
Çair Shkup

STATUT

(tekst i spastruar)

Dhjetor 2019

Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 alineja 1, në pajtim me nenin 19 paragrafi (2) dhe (3), neni 59 paragrafi (3) të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gz. Zyrtare e RMV” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18, 104/19, 146/19), neni 26 paragrafi 1 alineja 1 e Statutit të IPKKF “SNEZHANA” numër 0101-172/6 të datës 05.06.2013 dhe Vendimi numër 0202-226/2 të datës 13.12.2019. Këshilli Drejtues i Institucionit Publik Komunal për fëmijë – Kopshti për Fëmijë “SNEZHANA”Çair, Shkup në mbledhjen e mbajtur ,ë 13.12.2019 solli:

STATUT

të Institucionit Publik Komunal për fëmijë

Kopshti për Fëmijë SNEZHANA, Çair, Shkup

(tekst i spastruar: Statut numër 0101-172/6 të datës 05.06.2013, Vendim statutar për ndryshimin e Statutit numër 02-172/3 të datës 05.06.2013 dhe Vendimi për ndryshimin e Statutit numër 0202-164/2 të datës 10.10.2019)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Statut të Institucionit Publik Komunal për fëmijë – Kopshti për Fëmijë “SNEZHANA”Çair Shkup përcaktohet: titulli, selia, veprimtaria, vendosja organizative, menaxhimi dhe udhëheqja, organet profesionale, evidenca dhe dokumentimi, informimi, sekreti i veprimtarisë, mbrojtja, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare dhe çështje tjera nga puna e kopshtit për fëmijë.

Neni 2

Çështje të caktuara të cilat përcaktohen me këtë Statut mundën të rregullohen për së afërmi me rregullore, vendime, dhe akte tjera.

Neni 3

Titulli i Kopshtit për Fëmijë:

Javna Opshtinska Ustanova za deca – Detska Gradinka “SNEZHANA”Çair Skopje,
Institucioni publik Komunal për fëmijë - Kopshti për Fëmije SNEZHANA Çair – Shkup.

Selia e kopshtit për fëmijë është në rr. “Xhon Kenedi”numër 1 në Shkup.

Titulli i shkurtër është : JOUDG „SNEZHANA“ Çair Skopje, dhe në gjuhën shqipe dhe në alfabetin e saj IPKKF „SNEZHANA“ Çair – Shkup.

Neni 4

Kopshti për fëmijë “SNEZHANA”Çair Shkup është themeluar nga Këshilli popullor i qytetit të Shkupit me Aktvendim numër 5309/1 të datës 12.02.1970 për të cilën është dhënë pëlqim për punë.

Të drejtat dhe detyrimet themeluese mbi kopshtin për fëmijë ndërmerren nga Komuna e Çairit në pajtim me nenin 133-a nga neni 75 të Ligjit për ndryshim plotësim të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gz. Zyrtare nr. 65/04).

Neni 5

Kopshti për fëmijë në qarkullimin juridik me persona të tretë për detyrimet e tija përgjigjet me të gjitha mjetet me të cilat disponon dhe me të cilat shfrytëzohet e tërë përgjegjësia.

Neni 6

Kopshti për fëmijë ka vulë dhe shtembil në pajtim me Ligjin për vulën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vulave të organeve shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gz. Zyrtare e RMV 86/2008), Rregullorja për formën, madhësinë dhe përmbajtjes së vulave, mënyra e ruajtjes dhe përdorimit së tyre, si edhe për shtembilët e organeve shtetërore (Gz. Zyrtare e RMV 149/2009) dhe Ligji për përdorim e gjuhëve (Gz. Zyrtare e RMV 7/2019).

Vula e kopshtit për fëmijë ka formë të rrumbullakët.

Në mes të vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nën të cilën në formë rrethore së pari janë shkruar fjalët „Republika Severna Makedonija“/„Republika e Maqedonisë së Veriut“, nën to, po ashtu në formë rrethore, fjalët „Javna opshtinska ustanova za deca – Detska gradinska „SNEZHANA“ Çair- Skopje“/„Institucioni publik Komunal për fëmijë - Kopshti për fëmije SNEZHANA Çair - Shkup“.

Shtembili i kopshtit për fëmijë ka formë të drejtkëndëshit.

Në pjesën e sipërme të shtembilit janë shkruar fjalët “Republika Severna Makedonija“Javna opshtinska ustanova za deca – Detska gradinska „SNEZHANA“ Çair-Skopje“/„Republika e Maqedonisë së Veriut Institucioni publik Komunal për fëmijë - Kopshti për fëmijë SNEZHANA Çair - Shkup“.

Pjesa e poshtme e shtembilit shfrytëzohet për regjistrimin e datës dhe numrit të lëndës.

Neni 7

Me vulën dhe shtembilin disponon dhe e përdor personi i autorizuar nga drejtori i Kopshtit për Fëmijë.

Neni 8

Ndryshimi i titullit dhe ndryshimet statutare të kopshtit për fëmijë kryhen në pajtim me ligjin.

Neni 9

Kopshtin për fëmijë e përfaqëson dhe e parqet drejtori.

Në rast të pengesës ose mungesës Kopshtin për fëmijë do ta përfaqësojë dhe paraqesë personi të cilin ai e ka autorizuar.

Neni 10

Drejtori si përfaqësues është i autorizuar në emër të Kopshtit për fëmijë të lidhë kontrata dhe të kryejë veprime tjera juridike, si dhe ta përfaqësojë kopshtin e fëmijëve para gjyqeve dhe organeve tjera, institucione, organizata dhe institucione.

Neni 11

Drejtori i kopshtit për fëmijë në korniza të kompetencave të tija mundet të autorizojë person tjetër për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara juridike.

Neni 12

Emërimin e personave me autorizime të veçanta dhe përgjegjësi me aktvendim e bën drejtori i kopshtit për fëmijë në bazë të aktit për organizimin dhe sistemimin e punës së kopshtit për fëmijë.

II. ORGANIZIMI DHE PËRMBAJTJA E VEPRIMTARISË

Neni 13

Veprimtaria e kopshtit është kujdesi dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore.

Kujdesi dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore është formë e mbrojtjes së fëmijëve e cila si veprimtari organizohet për: kujdesje, qëndrim, kurim, ushqim, edukim, arsim, aktivitete sportive-rekreative, kulturo- zbavitëse, masa dhe aktivitete për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit dhe për nxitjen e zhvillimit intelektual, emocional, fizik, mendor dhe social të fëmijës deri në moshën 6 vjeçare, gjegjësisht deri në përfshirjen në arsimin fillor.

Kopshti për fëmijë:

- Organizon kujdes dhe edukim edhe për fëmijët me pengesa në zhvillimin trupor dhe intelektual në pajtim me ligjin;
- Siguron qëndrim dhe ushqim edhe për fëmijët mbi 6 vjet, gjegjësisht nga nisja në shkollë fillore deri në moshën 10 (dhjetë) vjeçare;
- Organizon edhe forma tjera të shkurtuara jashtë institucionale për kujdes dhe edukim edhe për fëmijë të cilët nuk janë përfshirë me mbrojtjen ditore sociale të fëmijëve në kopshtit për fëmijë;
- Kushte të caktuara nga veprimtaria e saj i organizon edhe në kushte tjera hapësinore;
- Jep shërbime të caktuara të fëmijëve dhe familjeve;
- Organizon edhe ruajtje të përkohshme të fëmijëve në kushte shtëpiake;
- Organizon edhe aktivitete tjera institucionale për përmbushjen e interesave dhe nevojave specifike të fëmijës dhe
- Jep shërbime edhe nga cilësia më e lartë nga e përcaktuara me standardet dhe normativat për kryerjen e veprimtarisë.

Neni 14

Në përbërje të kopshtit për fëmijë mundet të formohet edhe këshillimore për fëmijë dhe prindër.

Neni 15

Veprimtaria e kopshtit për fëmijë realizohet sipas planeve dhe programeve, në pajtim me ligjin.

Kopshti për fëmijë prindërve dhe kujdestarëve të fëmijëve ua parqet programet të cilat i realizon, qëllimet e tyre, përmbajtjet dhe metodat gjatë regjistrimit të fëmijës.

Puna edukative-arsimore e kopshtit për fëmijë realizohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj.

Për fëmijët e përkatësive të bashkësive tjera aktivitetet edukative – arsimore në kopshtin për fëmijë realizohen në gjuhën e bashkësisë përkatëse, për grup fëmijësh, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 16

Kujdesi dhe edukimi i fëmijëve në kopshtin për fëmijë realizohet në grupe, varësisht nga mosha e fëmijëve, sipas rregullës grupe homogjene dhe atë:

1. Deri në 12 muaj..... prej 6 deri më 8 fëmijë
2. Mbi 12 muaj deri më 18 muaj..... prej 8 deri më 10 fëmijë
3. Mbi 18 muaj deri më 2 vjeç..... prej 10 deri më 12 fëmijë
4. Mbi 2 vjeç deri më 3 vjeç..... prej 12 deri më 15 fëmijë
5. Mbi 3 vjeç deri më 4 vjeç..... prej 15 deri më 18 fëmijë
6. Mbi 4 vjeç deri më 5 vjeç..... prej 18 deri më 20 fëmijë
7. Mbi 5 vjeç deri më 6 vjeç..... prej 20 deri më 25 fëmijë

Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, varësisht nga mosha e fëmijëve, mundet të organizohet

- 1) Grupi heterogjen
 - Deri më 2 vjeç..... prej 10 deri më 12 fëmijë;
 - Prej 2 vjeç deri në fillimin në shkollë fillore..... prej 18 deri më 20 fëmijë;
- 2) Grup i kombinuar
 - Prej 12 muajsh deri në fillimin në shkollë fillore..... prej 18 deri më 20 fëmijë;
- 3) Grup fëmijësh me pengesa në zhvillim..... prej 5 deri më 8 fëmijë;
- 4) Grup fëmijësh prej gjashtë vjetësh, gjegjësisht nga fillimi në shkollë fillore deri më dhjetë vjeç prej 20 deri më 30 fëmijë;

Në grupet nga paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 1 dhe 2 të këtij neni mund të përfshihet një fëmijë me pengesa të lehta në zhvillimin mendor ose pengesë trupore, në të cilin rast numri i fëmijëve në grupet zvogëlohet për dy fëmijë.

Neni 17

Kopshti për fëmijë sjellë program vjetor për punë më së voni deri më 30 shtator të vitit momental, për vitin e ardhshëm.

Programi vjetor për punë përmban: organizim dhe kohë pune të kopshtit për fëmijë, programet e kopshtit për fëmijë, caktimin e fëmijëve nëpër grupe, puna e drejtorit dhe punëtorët profesional dhe tjerë, bashkëpunim me prindërit, bashkëpunim me institucionet edukative – arsimore, sportive, shëndetësore, kulturore, shkencore dhe tjera, fondacione, shoqata, aktivitete për përfshirjen e fëmijëve në kopsht, përkryerje profesionale të të punësuarve, puna me organet profesionale dhe punë tjera në realizimin e veprimtarisë.

Neni 18

Kopshti për fëmijë sipas kohëzgjatjes realizon programe për:

- Qëndrim tërë ditor
- Qëndrim gjysmë ditor
- Programe të shkurtuara
- Pilot Programe
- Program për qëndrim të vazhdueshëm
- Forma jashtë institucionale dhe
- Programe të veçanta

Programet për qëndrim tërë ditor zgjasin prej 8 deri më 11 orë dhe mundet të realizohen paradite, pasdite, tërë ditën ose pandryshuar.

Programet për qëndrim gjysmë ditor zgjasin prej 4 deri më 6 orë dhe mundet të realizohen paradite, pasdite ose pandryshuar.

Programet e shkurtuara zgjasin prej 240 deri më 600 orë në vit.

Programet për qëndrim tërë ditor dhe qëndrim gjysmë ditor janë të dedikuara për fëmijë të moshës deri në fillimin e arsimit fillor dhe përfshinë kujdesje dhe edukim të fëmijëve

Programet e shkurtuara janë të dedikuara për fëmijë nga vendet e braktisura ose demografikisht të rrezikuara, të moshës prej tre vjet deri në fillimin në shkollë fillore dhe përfshinë mbrojtje ditore sociale të fëmijëve me ose pa ushqim të fëmijëve.

Programet e shkurtuara janë dedikuara edhe për fëmijë të mjekimit spitalor të një kohe të gjatë.

Aktivitetet jashtë institucionale – ato janë programe të shkurta në kohëzgjatje prej tre ore në ditë të cilat mundën të përfshinë: lojëra, aktivitete lojërash, punëtori kreative, punëtori estetike nga lëmi i kulturës dhe artit, aktivitete sportive dedikuara për fëmijët e moshës prej tre vjet deri në fillimin e shkollës fillore - organizohen dhe realizohen nga kopshtet për fëmijë pas marrjes së lejes nga ministri pas mendimit të komisionit i përbërë prej dy përfaqësuesve nga institucioni shkencor, gjegjësisht institucioni,

një përfaqësues nga Biroja për zhvillim të arsimit, një përfaqësues nga institucioni i specializuar profesional dhe një përfaqësues nga Ministria.

Pilot programe janë programet me principe të veçanta pedagogjike të cilat realizohen në kopshtet për fëmijë pas marrjes së lejes nga ministri pas mendimit të komisionit i përbërë prej dy përfaqësuesve nga institucioni shkencor, gjegjësisht institucioni, një përfaqësues nga Biroja për zhvillim të arsimit, një përfaqësues nga institucioni i specializuar profesional dhe një përfaqësues nga Ministria.

Neni 19

Kopshti për fëmijë regjistron dhe pranon fëmijë në programet e tyre në bazë të fletëparaqitjeve gjatë tërë vitit.

Nëse në objektin e caktuar janë paraqitur për regjistrim numër më i madh fëmijësh nga numri i përcaktuar i fëmijëve në grupet nga neni 16 i këtij statuti, atëherë për pranim vendos Komisioni për pranim të fëmijëve.

Përbërja dhe mënyra e punës së Komisionit nga paragrafi 2 i këtij neni, si dhe nga kriteret për pranim të fëmijëve në kopsht i përcakton Këshilli drejtues i kopshtit në pajtim me Këshillin e komunës, ndërsa anëtarët e Komisionit i emëron Drejtori

Kundër ankesës kundër Aktvendimit të Komisionit vendos ministri.

Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni vendos edhe për realizimin e të drejtës së participimit.

Neni 20

Kopshti për fëmijë për shkak të ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit të fëmijëve e ndjek gjendjen shëndetësore të fëmijëve, bashkëpunon me institucione kompetente për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve dhe realizon masa preventive për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

kopshti për fëmijë ka për detyrë në rast të paraqitjes dhe të prishjes së gjendjes normale shëndetësore, ta lajmërojë prindërit, ndërsa në rast të numrit të madh të fëmijëve të sëmurë menjëherë ta lajmërojë institucionin kompetent shëndetësor, ministrinë si dhe themeluesin.

Prindërit janë të obliguar që të parashtrojnë vërtetim nga mjeku pediatër për gjendjen shëndetësore të fëmijës gjatë pranimit të fëmijës në kopshtin për fëmijë, gjegjësisht konstatim dhe mendim të institucionit përkatës profesional për fëmijë me pengesa në zhvillimin intelektual dhe fizik.

Organi i menaxhimit të kopshtit për fëmijë kujdeset në lidhje me pranimin e fëmijëve me pengesa në zhvillim, gjegjësisht për kushtet socio – ekonomike të familjes.

Të drejtat dhe detyrimet në mes Kopshtit për fëmijë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve (prind ose kujdestar të fëmijës) rregullohet me kontratë, me të cilën veçmas rregullohen marrëdhëniet e ndërsjella të dhënësit dhe shfrytëzuesit të shërbimit, cilësisë së shërbimeve, mënyra e pagesës, zgjedhja e programit, kohëzgjatja e qëndrimit në kopshtin e fëmijëve dhe çështje tjera në shikim të mbrojtjes së fëmijës dhe veprimtarisë së kopshtit.

III. VENDOSJA ORGANIZATIVE

Neni 21

Kopshti për fëmijë veprimtarinë e saj e realizon në 3 objekte dhe atë:

- Objekti „Xhuxhinja“ („Shkurtabiqët“) në rr. „Xhon Kenedi“ numër 1
- Objekti „Snegulko“ („Fjolla“) në rr. „Nikolla Grçeto“ numër 3

Në përbërje të kopshtit ekzistojnë Shërbimet e përbashkëta të cilat e bashkojnë punën dhe veprimtarinë të së gjitha objekteve dhe kryejnë punë profesionale për të gjithë

Shërbimet e përbashkëta me hapësirë janë vendosur në objektin „Xhuxhinja“ në rr. „Xhon Kenedi“ numër 1

Neni 22

Orari i punës i punëtorit në kopshtin për fëmijë është 40 orë në javë.

Orari i punës i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, për arsye të natyrës së punës, për edukatorin përkëdhelësin, caktohet në orar pune të kaluar me fëmijë dhe kohën tjetër të punës për aktivitete tjera programore.

Orari i punës i kaluar me fëmijë, si pjesë nga aktivitetet e përgjithshme programore në korniza të orarit të plotë të punës nga paragrafi 1 i këtij neni, për edukatorin është 30 orë në javë, ndërsa për përkëdhelësin 35 orë në javë.

Rroga bazë, kompensimi i rrogës dhe kompensimi i shpenzimeve lidhur me punën, llogariten dhe i paguhen punëtorit në bazë të orarit të punës nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe evidencën të cilën e mban punëdhënësi.

Fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të kopshtit për fëmijë i përcakton me akt Këshilli i Komunës së Çairit.

IV. MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA

Këshilli drejtues

Neni 23

Organ i menaxhimit në kopshtin për fëmijë është Këshilli Drejtues.

Neni 24

Këshilli drejtues i kopshtit për fëmijë numëron 7 (shtatë) anëtarë dhe atë:

- dy përfaqësues nga themeluesi
- një përfaqësues nga Qyteti i Shkupit
- një përfaqësues i kopshtit për fëmijë
- dy përfaqësues të prindërve
- një përfaqësues nga ministria

Përfaqësuesit e themeluesit i emëron dhe i shkarkon Këshilli i Komunës së Çairit

Përfaqësuesin e Qytetit të Shkupit e propozon Këshilli i Qytetit të Shkupit, ndërsa e emërton dhe e shkarkon Këshilli i Komunës së Çairit, në procedurë të paraparë me këtë Statut.

Përfaqësuesin e ministrisë e propozon ministri, ndërsa e emërton dhe shkarkon Këshilli i Komunës së Çairit.

Përfaqësuesit e prindërve i propozon Këshilli i prindërve, ndërsa e emërton dhe shkarkon Këshilli i Komunës së Çairit.

Përfaqësuesin e kopshtit për fëmijë e propozon Këshilli Profesional i kopshtit, në bazë të kompleksitetit profesional, ndërsa e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli i Komunës së Çairit, në procedurë të paraparë me këtë Statut.

Përfaqësuesit e themeluesit, të Qytetit të Shkupit, ministrisë dhe prindërit nuk mundën të emërohen nga radhët e të punësuarve në kopshtin për fëmijë.

Neni 25

Anëtarët e Këshillit drejtues emërohen për periudhë prej 4 vjetësh.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues fillon të rrjedhë nga dita e konstituimit të tij.

Mbledhjen e konstituive të Këshillit Drejtues e thërret dhe deri në zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Drejtues udhëheq anëtari më i moshuar.

Neni 26

Këshilli drejtues i kopshtit për fëmijë :

- sjell Statut të kopshtit për fëmijë
- propozon program vjetor për punë dhe raport për punë deri te Këshilli i komunës
- Propozon plan financiar deri te Këshilli i komunës
- Propozon llogari vjetore deri te Këshilli i komunës
- Shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit të kopshtit për fëmijë
- Kryen intervistë me kandidatët për zgjedhje të drejtorit
- I propozon kryetarit të komunës një kandidat nga kandidatët e paraqitur në konkursin e shpallur për zgjedhje të drejtorit.
- Sjell akt për organizimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës të institucionit, të cilit pëlqim i jep Këshilli i komunës.
- Vendors ndaj kundërshtesave dhe ankesave të të punësuarve
- Vendors ndaj ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve
- Sjellë rregullore për punën e saj
- Sjellë akte për rroga dhe kompensime
- Debaton ndaj konstatimeve dhe mendimeve pas raportit të mbikëqyrjes profesionale dhe mbikëqyrje mbi ligjshmërinë në punë dhe punën.
- Sjellë vendim për përcaktimin e përbërjes dhe punës së komisionit për pranim të fëmijëve.

- Sjellë rregullore për mënyrën e arritjes dhe caktimit të mjeteve në bazë të kryerjes së shërbimeve të cilësisë së lartë dhe shitjen e prodhimeve vetanake.
- Sjellë vendim për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve për cilësinë më të lartë se e përcaktuara me standarde dhe normativa.
- Zgjedh komision tre anëtarësh i cili i kontrollon dokumentet e arritura nga kandidatët e paraqitur në konkursin publik për zgjedhje të drejtorit.
- Formon komisione të përhershme dhe të përkohshme ndaj çështjeve të caktuara lidhur me punën e kopshtit për fëmijë.
- Shqyrton dhe vendos edhe për punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.

Në punën e Këshillit Drejtues merr pjesë drejtori i kopshtit për fëmijë, pa të drejtë vote.

Neni 27

Me këshillin drejtues udhëheq kryetari i Këshillit Drejtues, ndërsa në rast mungese ose pengese e zëvendëson zëvendësi i tij.

Kryetari i Këshillit Drejtues dhe zëvendësi i tij zgjidhen me propozim të anëtarëve të Këshillit drejtues me votim publik dhe me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Votimi për kryetar të Këshillit drejtues dhe zëvendësit të tij është individual.

Kryetari i Këshillit drejtues i cakton mbledhjet e këshillit dhe udhëheq me të njëjtët, në pajtim me përcaktimin e rendit të ditës.

Këshilli drejtues sjellë vendim me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Neni 28

Mbledhjet e Këshillit drejtues i thërret kryetari i këshillit drejtues me iniciativë të vet, me kërkesë të së paku 4 (katër) anëtarë nga Këshilli drejtues ose me iniciativë të drejtorit të kopshtit për fëmijë.

Neni 29

Vendimi për fillimin e procedurës për emërimin e përfaqësuesit në këshillin drejtues të kopshtit për fëmijë dorëzohet më së voni 30 ditë para skadimit të kohës për të cilën janë emëruar përfaqësuesit e këshillit drejtues.

Neni 30

Mandati i anëtarit të Këshillit drejtues mundet ti ndërpritet para skadimit të kohës për të cilën është emëruar nëse shkarkohet nga organi i cili e ka emëruar.

Propozim për shkarkim të anëtarit të Këshillit drejtues para skadimit të kohës për të cilën është emëruar sjellë Këshilli drejtues me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit drejtues, përveç për përfaqësuesit e themeluesit, për përfaqësuesin e Qytetit të Shkupit dhe përfaqësuesin e ministrisë.

Këshilli drejtues do të sjellë propozim për shkarkimin e anëtarit të Këshillit drejtues para skadimit të kohës për të cilën është emëruar në këto raste:

- Parregullsi ose pengese të merr pjesë në punën e Këshillit drejtues.
- Nëse është ndërprerë baza për emërim
- Nëse punon në kundërshtim me statutin, ligjin dhe aktet tjera të komunës dhe
- Me kërkesë personale

Këshilli drejtues për përfaqësuesit e themeluesit mundet të dorëzojë iniciativë për shkarkim deri te Këshilli i komunës në rastet e përcaktuara në alinenë 1, 2 dhe 3 nga paragrafi 3 i këtij neni.

Këshilli drejtues për përfaqësuesit e Qytetit të Shkupit mundet të dorëzojë iniciativë për shkarkim deri te Këshilli i Qytetit të Shkupit, në rastet e përcaktuara në alinenë 1, 2 dhe 3 nga paragrafi 3 i këtij neni.

Këshilli drejtues për përfaqësuesin e Ministrisë mundet të dorëzojë iniciativë për shkarkim deri te Ministri, në rastet e përcaktuara në alinenë 1, 2 dhe 3 nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 31

Përfaqësuesin e Këshillit drejtues të kopshtit për fëmijë e propozon këshilli profesional i institucionit, në bazë të profesionalizmit dhe kompleksitetit, ndërsa e zgjedh dhe e shkarkon themeluesi në procedurë të paraparë me statutin e institucionit.

Propozimin e përfaqësuesit në Këshillin drejtues këshilli profesional e kryen me propozim të anëtarëve të këshillit profesional me votim publik, me shumicën e votave.

Neni 32

Puna e Këshillit drejtues për së afërmi rregullohet me Rregullore për punë të Këshillit drejtues.

ORGANI I UDHËHEQJES

Neni 33

Drejtori është organi i udhëheqjes së kopshtit për fëmijë.

Drejtori është përfaqësuesi ligjor i kopshtit për fëmijë dhe e përfaqëson dhe paraqet para personave të tretë.

Neni 34

Për drejtor të kopshtit për fëmijë mund të jetë i emëruar, gjegjësisht të zgjidhet personi i cili përskaj kushteve të përcaktuara me ligj dhe me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve është me arsim sipëror (me arritje të 240 kredive sipas EKTC ose të kryer VII/1) dhe i përmbushin kushtet e parapara në Ligjin për mbrojtje të fëmijëve për edukatorë, punëtor profesional, bashkëpunëtor profesional, person me kryerje të fakultetit filologjik - programi studimor mësimor dhe studime të specializuara për pedagogë parashkollor, jurist, ekonomist me arsim sipëror (me arritje të 240 kredive sipas EKTC ose të kryer VII/1) dhe mbi katër vjet përvojë pune pas diplomimit dhe posedon licencë të vlefshme për drejtor të institucionit për fëmijë.

Kandidati për drejtor të kopshtit për fëmijë obligueshëm dorëzon edhe program për punë të kopshtit për fëmijë.

Neni 34a

Këshilli drejtues zgjedh komision prej 3 anëtarësh i cili i kontrollon dokumentet e arritura të kandidatit për drejtor.

Anëtarët e komisionit zgjidhen nga radhët e të punësuarve në kopshtin për fëmijë.

Komisioni e ka këtë kompetencë:

- I kontrollon dokumentet e arritura nga kandidatët për drejtor.
- Në afat prej pesë dite pas mbarimit të konkursit i shqyrton dokumentet e arritura për drejtor.

- Kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara në konkursin iu kthehen dokumentet me arsyetim.
- Dokumentacionin e gjithëmbarshtëm nga kandidatët e dorëzon deri te Këshilli drejtues.

Neni 35

Drejtorin e kopshtit për fëmijë e zgjedh dhe e shkarkon Kryetari i Komunës.

Pas skadimit të afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, i njëjti person ka të drejtë edhe në një mandat një pas një, ndërsa mundësi për zgjedhje të sërishme, gjegjësisht emërim, i njëjti person ka të drejtë pas skadimit të katër viteve nga zgjedhja e tij e fundit, gjegjësisht emërimit.

Pas skadimit të mandatit i njëjti person mundet përsëri të emërohet për drejtor.

Neni 36

Tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit aktual, Kryetari i komunës sjell vendim që Këshilli drejtues të shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit.

Konkursi publik për emërim të drejtorit të kopshtit për fëmijë e shpall këshilli drejtues i kopshtit për fëmijë.

Konkursi publik nga paragrafi 1 i këtij neni shpallet në gazetatat publike dhe i njëjti zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e shpalljes.

Në shpalljen e konkursit publik për përcaktimin e kushteve të cilat duhet ti përmbush kandidati për drejtor, dokumentacioni i nevojshëm, kohëzgjatja e konkursit publik dhe afati në të cilin do të kryhet zgjedhja.

Kandidatët e paraqitur i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, në pajtim me konkursin deri te këshilli drejtues.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i zgjedhur nga Këshilli drejtues përbërja dhe kompetencat e të cilit përcaktohen me Statutin e Institucionit.

Komisioni është i obliguar në afat prej 5 (pesë) dite pas përfundimit të konkursit ti shqyrtojë dokumentet e arritura.

Kandidatëve të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet iu kthehen dokumentet me arsyetim.

Këshilli drejtues në afat prej shtatë dite nga intervista e kryer me kandidatët, kryetari të komunës i propozon një kandidat për zgjedhje të drejtorit.

Kryetari i komunës në afat prej 15 ditësh nga marrja e propozimit kryen zgjedhjen e drejtorit.

Nëse kryetari i komunës nuk zgjedh drejtor në afatin e caktuar, është i obliguar në afat prej 3 ditësh ta njoftojë Këshillin drejtues.

Këshilli drejtues në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimi të njoftimit, kryetarit të komunës i propozon një kandidat për zgjedhje të drejtorit.

Kryetari i komunës është i obliguar në afat prej pesë dite nga dita e refuzimit të propozimit ta njoftojë kandidatin e propozuar nga Këshilli drejtues.

Kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të vendimit të Kryetarit të komunës, kanë të drejtë ankese në lidhje me realizimin e procedurës për zgjedhje deri te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative nga marrëdhënia e punës e shkallës së dytë.

Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi 14 i këtij neni kandidati ka të drejtë të paraqesë kontest administrativ.

Neni 36a

Nëse drejtori i kopshtit të fëmijëve shkarkohet para skadimit të mandatit ose para kohe i ndërpritet mandati si edhe në rastin kur është zgjedhur, Kryetari i komunës në afat prej tre dite nga dita e shkarkimit të drejtorit emëron ushtrues detyre drejtor nga radhët e të punësuarve të cilët i përmbushin kushtet për drejtor dhe i cili i kryen punët e drejtorit deri në emërimin e drejtorit të ri, më së shumti deri në gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

Neni 37

Drejtori i kopshtit për fëmijë:

- E organizon dhe udhëheq punë e institucionit
- Është përgjegjës për ligjshmërinë dhe punën e institucionit
- në mënyrë të pavarur sjell vendime nga fushëveprimi i kompetencës së tij dhe aktet e fushëveprimit të kompetencës së tij dhe aktet e kopshtit për fëmijë
- E përfaqëson kopshtin për fëmijë para personave të tretë
- e propozon programin vjetor për punë të keshillit drejtues dhe ndërmerr masa për realizimin e saj
- i përmbaron vendimet e Keshillit drejtues

- vendos për themelim dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës të punëtorëve për kryerjen e veprimtarisë në pajtim me ligji, aktet e kopshtit për fëmijë dhe marrëveshjes kolektive
- kryen caktimin e punëtorëve
- dorëzon raport për realizimin e programit vjetor për punë deri te këshilli drejtues, themeluesi dhe ministria.
- dorëzon raport për punën e institucionit gjatë vitit deri te Këshilli drejtues, themeluesi
- e dorëzon raport për punën materiale financiare të kopshtit për fëmijë deri te Këshilli drejtues dhe deri te themeluesi dhe është përgjegjës për punën materiale - financiare
- dorëzon raport për realizimin e programeve deri te këshilli drejtues, themeluesi dhe ministri
- formon komisione të përhershme dhe të përkohshme për çështje të caktuara lidhur me punën dhe organizimin e punës
- emëron anëtarë të Komisionit për pranimin e fëmijëve.
- Lidhë kontrata në pajtim me ligjin
- lejon mungesë të punësuarve, sjellë vendime për pushime vjetore, për rroga në pajtim me ligjin, aktet e përgjithshme dhe marrëveshjen kolektive
- përcakton zëvendës për mungesën befas të punëtorëve
- kryeson dhe udhëheq me Këshillin profesional
- kryen vlerësimin e nëpunësve publik në IP
- kryen edhe punë tjera të parapara me ligj, statut dhe akte tjera të kopshtit për fëmijë

Neni 38

Drejtori i kopshtit për fëmijë mund të jetë i shkarkuar:

- me kërkesë personale
- nëse nuk e realizon ligjin dhe aktet e përgjithshme të sjella në pajtim me ligjin
- Nëse nuk e realizon programin vjetor për punë të institucionit

- nëse për fajin e tij iu është shkaktuar dëm fëmijëve, prindërve ose kujdestarëve të tyre, kopshtit për fëmijë, themeluesit ose shtetit
- nëse lejon pagesë të mjeteve të cilat nuk janë të parapara në planin vjetor financiar të kopshtit për fëmijë
- nëse lejon organizim të veprimtarisë në kundërshtim me ligjin, aktet e përgjithshme të sjella në pajtim me ligjin dhe programin vjetor për punë
- në raste tjera të përcaktuara me ligj

Nëse ekzistojnë njohuri të caktuara për veprimin e drejtorit në pajtim me dispozitat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 Këshilli drejtues i kopshtit për fëmijë thërret mbledhje në të cilën sillet konkluzion në formë të shkruar i cili dorëzohet deri te drejtori.

Drejtori ka të drejtë në afat prej shtatë dite nga pranimi të prononcohet për kërkesat në konkluzion.

Nëse Këshilli drejtues i kopshtit për fëmijë nuk i pranon prononcimet e drejtorit, thërret mbledhje në afat prej tre ditëve dhe në prezencë të përfaqësuesit nga institucioni shkencor ose profesional special, gjegjësisht organi profesional bën dëgjim të drejtorit. Përfaqësuesi jep mendim për arsyetimin e shkarkimit të drejtorit.

Nëse Këshilli drejtues vlerëson se është e patjetërsueshme, në afat prej shtatë dite dorëzon propozim për shkarkimin e drejtorit deri te kryetari i komunës.

Kryetari i komunës është i obliguar në afat prej pesë dite nga dita e marrjes së propozimit nga Këshilli drejtues ta shkarkojë drejtorin.

Drejtori i shkarkuar, në afat prej 15 dite nga dita e pranimi të vendimit të kryetarit të komunës ka të drejtë ankese në lidhje me realizimin e procedurës të komisionit të shkallës së dytë të Qeverisë kompetent për zgjedhje të çështjes nga lëmi i marrëdhënieve të punës.

Kundër vendimit të Komisionit, drejtori i shkarkuar ka të drejtë padie deri te gjyqi themelor kompetent.

Kryetari i komunës, në afat prej tre dite nga dita e shkarkimit të drejtorit, emëron ushtrues detyre drejtor nga radhët e të punësuarve të institucionit të cilët i përmbushin kushtet për drejtor, më së shumti deri në gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

Neni 39

Drejtori i kopshtit për fëmijë i cili nuk është eruar përsëri për drejtor të kopshtit për fëmijë ose është i shkarkuar ka të drejta dhe detyrime të marrëdhënies së punës në pajtim me ligj.

V. ORGANE PROFESIONALE

Neni 40

Organet profesionale të kopshtit për fëmijë janë:

- Këshilli profesional;
- Këshilli i edukatorëve dhe
- Këshilli i përkëdhelësve

Këshilli profesional

Neni 41

Këshillin profesional e përbëjnë: drejtori, punëtorët profesional, bashkëpunëtorët profesional dhe personat me autorizime të veçanta.

Neni 42

Me këshillin profesional udhëheq drejtori i kopshtit për fëmijë.

Këshilli profesional i kryen këto punë:

- Përcakton baza profesionale për realizimin e programit për punë;
- jep mendim dhe propozime deri te drejtori në shikim të organizimit të punës dhe kushteve të punës.
- i shqyrton programet dhe planet për punë dhe ndërmarr masa për realizimin e tyre;
- i shqyrton raportet për mbikëqyrjen e kryer profesionale mbi realizimin e programeve dhe propozon masa përkatëse;
- e shqyrton planin për përkryerje profesionale të kuadrit në kopshtin e fëmijëve;
- emëron dhe shkarkon përfaqësues të institucionit publik për fëmijë në Këshillin drejtues të kopshtit të fëmijëve nga radhët e të punësuarve të cilët kryejnë punë profesionale;

- i përcakton nevojat e objektit të materialit të lojërave didaktike dhe tjera për punën me fëmijë, si dhe nevojat për mjetet bazë dhe materialit harxhues për realizimin normal të veprimtarisë.

Këshilli profesional vendimet i sjell me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të keshillit.

Këshilli i edukatorëve

Neni 43

Këshillin e edukatorëve e përbëjnë edukatorët e kopshtit për fëmijë.

Me këshillin e edukatorëve udhëheq dhe i thërret drejtori i kopshtit për fëmijë.

Këshilli i edukatorëve i kryen këto punë:

- e harmonizon punën e edukatorëve në kopshtin për fëmijë;
- i shqyrton përmbajtjet për punë në pajtim me programet;
- e realizon programin për përkryerje profesionale;
- merr pjesë në përgatitjen dhe realizimin e programeve për punë dhe formave tjera të punës me fëmijët;
- bashkëpunon me këshillin e prindërve dhe këshillin e përkëdhelësve;
- kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga realizimi i programeve, planet dhe forma tjera të realizimit të veprimtarisë.

Këshilli i përkëdhelësve

Neni 44

Këshillin e përkëdhelësve e përbëjnë përkëdhelësit e kopshtit për fëmijë.

Me këshillin udhëheq drejtori i kopshtit për fëmijë.

Këshilli i përkëdhelësve:

- e harmonizon punën e përkëdhelësve në kopshtin për fëmijë;
- e realizon programin për përkryerje profesionale të përkëdhelësve në kopshtin për fëmijë
- shqyrton përmbajtje të punës në pajtim me programet dhe

- bashkëpunon me këshillin e edukatorëve dhe këshillin e prindërve.

Neni 45

Në kopshtin për fëmijë edukatorët dhe përkëdhelësit mundet të organizohen në aktive në nivel të objekteve për realizimin e detyrave të caktuara, konsultime, planifikime dhe punë tjera të cilat dalin nga puna.

VI. KËSHILLI I PRINDËRVE

Neni 46

Në kopshtin për fëmijë zgjidhet këshilli i prindërve të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e prindërve fëmijët e të cilëve qëndrojnë në kopshtin për fëmijë.

Këshilli i prindërve numëron 5 (pesë) anëtarë, në përpjesëtim me numrin e fëmijëve nga secili objekt i kopshtit për fëmijë.

Kur anëtari i këshillit të prindërve ndërpret të jetë prindër zgjidhet prind tjetër nga i njëjti objekt si përfaqësues i këshillit.

Neni 47

Këshilli i prindërve nga anëtarët e tij emëron dy përfaqësues në Këshillin drejtues, me shumicën e votave.

Me këshillin udhëheq kryetari të cilin e zgjedhin anëtarët e këshillit të prindërve me votim publik nga radhët e tyre, me shumicën e votave.

Deri në zgjedhjen e kryetarit me këshillin e prindërve udhëheq anëtari më i moshuar.

Neni 48

Anëtarëve të këshillit të prindërve iu sigurohet kushte hapësinore për punën e kopshtit për fëmijë.

Neni 49

Këshilli i prindërve e ndjek, shqyrton dhe jep mendim për realizimin e veprimtarisë në kopshtin e fëmijëve.

Këshilli i prindërve veçmas do të angazhohet në dhënien e ndihmës për realizimin e aktiviteteve të hartuara, në programet për punë me fëmijët.

Këshilli i prindërve angazhohet edhe në gjetjen e mjeteve nga fondacionet, dhuratat, trashëgimitë, testamentet dhe mjetet në bazë të të solidaritetit në para dhe naturë, me qëllim për përmirësimin e kushteve për qëndrim dhe punë me fëmijët.

Neni 50

Këshilli i prindërve për mjetet nga neni 49 të këtij statuti, të cilat janë rreptësisht qëllimore, në secilën kohë mundet të kërkojë raport nga Drejtori dhe Këshilli drejtues për realizimin e të njëjtëve.

VII. EVIDENTIMI DHE DOKUMENTIMI

Neni 51

Në kopshtin e fëmijëve mbahet edhe evidencë edhe dokumentacion.

Evidenca dhe dokumentacioni mbahen edhe për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe dokumentacionit dhe formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit i parasheh ministri.

Në kopshtin e fëmijëve mbahet dokumentacioni pedagogjik dhe evidenca pedagogjike për aktivitetet edukative-arsimore.

Dokumentacioni pedagogjik e përfshin librin kryesor të fëmijëve dhe paraqet dokumente me vlerë të përhershme.

Evidenca pedagogjike përfshinë: ditarin e punës në kopshtin, ditarin për punë në grupin edukativ, planifikim dhe përgatitje të punës edukative- arsimore dhe dosjen e fëmijës.

Dokumentacioni pedagogjik në kopshtin për fëmijë mbahen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, dhe në gjuhën shqipe dhe gjuhën e saj.

Për përkatësitë e bashkësive etnike të cilët aktivitetet edukative – arsimore i realizojnë në gjuhën e bashkësisë përkatëse, evidenca pedagogjike mbahet në gjuhën maqedonase me përdorimin e alfabetit të saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilën realizohet aktiviteti edukativo-arsimor.

Forma dhe përmbajtja, si dhe mënyra e mbajtjes së dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike i parasheh ministri.

Kopshti për fëmijë mban evidencë të personave të cilët përkohësisht ruajnë fëmijë në pajtim me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve.

VIII. AKTET E PËRGJITHSHME TË KOPSHTIT PËR FËMIJË

Neni 52

Statuti i kopshtit për fëmijë është akt bazë.

Përskaj statutit kopshti për fëmijë i ka edhe këto akte të përgjithshme:

- rregullore për organizimin e punës të kopshtit për fëmijë;
- rregullore për organizimin dhe sistemimin e vendeve të punës të kopshtit për fëmijë;
- marrëveshje kolektive në nivel të kopshtit për fëmijë;
- rregullore për mbrojtje nga zjarri;
- rregullore për mbrojtje gjatë punës;
- rregullore për kontabilitet, regjistrim dhe harmonizim të mjeteve dhe burimeve të tyre, amortizimi dhe revalorizimi i mjeteve;
- rregullore për furnizime publike;
- rregullore për furnizime publike të vlerës së vogël.

Kopshti për fëmijë sipas nevojës mund të sjellë edhe akte tjera të përgjithshme.

Të gjitha aktet e përgjithshme nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni patjetër të jenë në pajtim me rregullat dhe dispozitat pozitive ligjore nga ky statut.

Neni 53

Statuti dhe aktet tjera të përgjithshme të kopshtit për fëmijë, përveç Marrëveshjes kolektive, i sjellë Këshilli drejtues me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Për përpilimin e statutit dhe akteve tjera të përgjithshme, Këshilli drejtues mundet të formojë komision.

Iniciativë për sjellje, ndryshim dhe plotësim të statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të kopshtit për fëmijë mundet të dorëzojnë: drejtori, anëtari i Këshillit drejtues dhe sindikata.

Neni 54

Aktet e përgjithshme të kopshtit për fëmijë të sjella nga Këshilli drejtues shpallen në tabelën e shpalljes dhe hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes.

IX. INFORMIMI

Neni 55

Puna e kopshtit për fëmijë dhe organeve të tij janë publike.

Këshilli drejtues dhe organi i udhëheqjes janë të obliguar të sigurojnë njoftim të rregullt, në kohë, të plotë dhe për nga përmbajtja dhe forma të kapshme për të punësuarit dhe prindërit e fëmijëve.

Neni 56

Organet e kopshtit për fëmijë janë të obliguar të lajmërojnë për secilën çështje e cila i përket realizimit të veprimtarisë, programeve, punës financiare dhe çështje tjera me rëndësi për punën e kopshtit për fëmijë, me shpallje të vendimeve më të rëndësishme në tabelat e shpalljeve në objektet.

Informimi mundet të bëhet edhe nëpërmjet botimit të gazetës, buletinit e tjerë.

Neni 57

Dita e kopshtit për fëmijë është 21 Mars. Kjo ditë shënohet nëpërmjet organizimit të manifestimeve të ndryshme kulturore, sportive –rekreative e tjera me fëmijë para prindërve, organeve, organizatave dhe bashkëpunëtorëve tjerë.

Neni 58

Kopshti për fëmijë mundet të marrë pjesë në aktivitete (ekspozita, shfaqe dhe manifestime tjera) jashtë kopshtit për fëmijë me qëllim për prezantim më të suksesshëm të veprimtarisë së komunës, qytetit, republikës dhe më gjerë në botë.

Neni 59

Në kopshtin për fëmijë përdoren doracak si materiale edukative arsimore për realizimin e aktiviteteve nga ana e kuadrit kujdesës –edukativ, si dhe revistat për fëmijë të cilat janë në funksion të aktiviteteve të njëjta.

Përkatesitë e bashkësive të cilët aktivitetet edukative – arsimore i realizojnë në gjuhën e përkatesive të bashkësive tjera, përdorin doracak dhe revista për fëmijë në gjuhën e bashkësisë përkatese.

Aktvendim për lejim dhe përdorim të doracakëve dhe revistave për fëmijë sjellë ministri, me mendim paraparak të Shërbimit pedagogjik, gjegjësisht institucionit të specializuar profesional.

X. SEKRETI I VEPRIMTARISË

Neni 60

Për shkak të mbrojtjes së interesave të kopshtit për fëmijë, kopshti për fëmijë ndërmerr masa për ruajtjen, përdorimin, shfrytëzimin dhe kumtimin e të dhënave të cilët llogaritet si sekret i veprimtarisë.

Si sekret i veprimtarisë llogariten patentën dhe dokumentet të cilat ndodhin në realizimin e veprimtarisë së kopshtit për fëmijë, ndërsa bartja e të cilëve në publik ose kumtim të personit të paautorizuar, për shkak natyrës dhe rëndësisë së tyre, do të mundej të shkaktonin dëm kopshtit për fëmijë, prindërve ose personave të tretë.

Neni 61

Të gjitha të dhënat dhe dokumentet të cilat janë paraparë si sekret i veprimtarisë kanë shenjë “të besueshme” ose “rreptësisht të besueshme”

Detyrimi për ruajtjen e sekretit të veprimtarisë zgjatë derisa drejtori i kopshtit për fëmijë ose organi i cili i ka dorëzuar të dhënat nuk jep pëlqim për lirim nga ruajtja e sekretit të veprimtarisë.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit të veprimtarisë zgjatë edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punëtorit i cili ka qenë i njohur me përmbajtjen e dokumenteve të besueshme.

XI. MBROJTJA

Neni 62

Në gjendje lufte kopshti për fëmijë vazhdon me realizimin e veprimtarisë, për shkak të së cilës në kuadër të punës së tij të rregullt në paqe, në pajtim me Ligjin për mbrojtje dhe rregulla tjera realizon përgatitje përkatëse dhe përpilon dokumente për punë në gjendje lufte.

Me realizimin e përgatitjeve dhe përpilimit të dokumenteve për punë në gjendje lufte udhëheq drejtori i kopshtit për fëmijë.

Neni 63

Për shkak të mbrojtjes së të dhënave dhe informatave sekrete nga sfera e mbrojtjes, kopshti për fëmijë realizon masa për mbrojtjen e sekretit të të dhënave me rëndësi për mbrojtjen.

XII. ORGANI PËR KONTROLL TË BRENDSHËM - ORGANI MBIKËQYRËS

Neni 63-a

Për kryerjen e kontrollit të brendshëm të punës së institucionit publik për fëmijë, themeluesi formon organ mbikëqyrës.

Organin mbikëqyrës e përbëjnë tre deri më pesë anëtarë të emëruar nga themeluesi

Anëtarët e Organit mbikëqyrës zgjidhen me mandat në kohëzgjatje prej katër vitesh

Për anëtarë të Këshillit mbikëqyrës munden të emërohen persona të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie pune në kopshtin e fëmijëve, kanë të kryer arsim sipëror dhe posedojnë njohuri dhe përvojë nga veprimtaria e institucionit.

Organin mbikëqyrës e thërret dhe me punën e tij udhëheq kryetari, të cilin e zgjedhin anëtarët e organit mbikëqyrës nga radhët e tij.

Organi mbikëqyrës vendimet e tij i sjell me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Neni 63-b

Organi mbikëqyrës bën kontroll të punës materiale-financiare të Kopshtit për fëmijë, shfrytëzimin dhe disponimin e mjeteve të institucionit dhe për konstatimet dorëzon raport deri te themeluesi, Ministria, Këshilli drejtues dhe drejtori i Kopshtit për fëmijë.

Me Organin mbikëqyrës udhëheq kryetari i Organit mbikëqyrës, ndërsa në rast mungese ose pengese e zëvendëson zëvendësi i tij.

Kryetari i Organit mbikëqyrës dhe zëvendësi i tij zgjidhen me propozim të anëtarëve të Organit mbikëqyrës me votim publik dhe me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Votimi për kryetar të Organit mbikëqyrës dhe zëvendësit të tij është individuale.

Kryetari i Organit mbikëqyrës i cakton mbledhjet e këshillit dhe udhëheq me të njëjtët, në pajtim me përcaktimin e rendit të ditës.

Organi mbikëqyrës sjellë vendime me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Mbledhjet e Organit mbikëqyrës i thërret kryetari i Organit mbikëqyrës me iniciativë të vet.

Mandati i anëtarit të Organit mbikëqyrës mundet ti ndërpritet para skadimit të kohës për të cilën është emëruar nëse shkarkohet nga organi i cili e ka emëruar.

Propozim për shkarkim të Organit mbikëqyrës para skadimit të kohës për të cilën është emëruar sjellë Organi mbikëqyrës me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Organit mbikëqyrës.

Organi mbikëqyrës do të sjellë propozim për shkarkimin e anëtarit të Organit mbikëqyrës para skadimit të kohës për të cilën është emëruar në këto raste:

- parregullsi ose pengesë të merr pjesë në punën e Organit mbikëqyrës
- nëse iu është ndërprerë baza për emërim
- nëse punon në kundërshtim me statutin, ligjin ose aktet tjera të kopshtit për fëmijë dhe
- me kërkesë personale.

XIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 64

Kopshti për fëmijë me titullin e ri nga neni 3 i këtij statuti regjistrohet në gjyqin kompetent.

Neni 65

Procedura për ndryshim plotësimin e këtij statuti është ekuivalente si edhe procedura për sjelljen e tij.

Neni 66

Aktet e përgjithshme të kopshtit për fëmijë do të harmonizohen me dispozitat e këtij statuti në afat prej 60 dite nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

Deri në sjelljen e akteve të përgjithshme, në rast kur dispozitat e akteve të përgjithshme janë në kundërshtim me statutin, drejtpërdrejtë do të zbatohen dispozitat pozitive ligjore.

Neni 67

Nga dita e sjelljes së këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i institucionit për fëmijë – Kopshti për fëmijë “Snezhana” Çair – Shkup numër 0101-38 të datës 18.02.2010.

Neni 68

Ky Statut hynë në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në tabelat shpallëse në objektet e kopshtit për fëmijë, pas marrjes pëlqim nga Këshilli i komunës.

Numër 0101-228

VV

Kryetar i Këshillit drejtues

Të datës 13.12.2019

Husamet Agushovski